



Nr. 008 Prot

Nr. 989 Prot

Tiranë, 24/06/2025

Tiranë, 24/06/2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

QËNDRËS PËR TË DREJTAT NË PUNË

PËR

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

ROBERT GAJDA

KOMISIONER



PËR

**QËNDRËN PËR TË DREJTAT NË
PUNË**

EDISON HOXHA

DREJTOR EKZEKUTIV



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur sot më ___ / ___ / ____, në Tiranë ndërmjet:

Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), përfaqësuar nga Komisioneri Z. Robert Gajda, me adresë: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, *(në vijim cilësuar si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi)*,

dhe

Qëndrës për të Drejtat në Punë (CLR), regjistruar si person juridik me vendim Nr. 1134/3, datë 20.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT L71306451H, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Edison Hoxha, me adresë: Rr. "Frederik Shiroka", Godina "Alba", Hyrja 4, Ap.7, Tiranë. Tel: +355694702057, Email: info@clr.al *(në vijim referuar si "CLR")*.

Institucioni i **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, si person juridik publik, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, dhe **Qendra për të Drejtat në Punë**, si person juridik, e cila ka si mision mbështetjen dhe angazhimin në programe dhe projekte që u mundësojnë punonjësve të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë që të përmirësojnë kushtet e tyre të punës dhe të jetesës; të nxisë dhe mbrojë të drejtën e asociimit dhe të promovojë punë të denjë, drejtësi sociale dhe barazi për zhvillimin e qëndrueshëm demokratik të shoqërisë shqiptare, **kanë** një eksperiencë dhe përvojë të gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave me në fokus antidiskriminimin në fushën e punësimit, dhe dëshirojnë që të çojnë përpara bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet tyre në këtë fushë, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për sa më poshtë:

Neni 1

OBJEKTI

Kjo marrëveshje ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra për të Drejtat në Punë do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjelltë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, duke patur në vëmendje të veçantë fushën e punësimit.



Neni 2

QËLLIMI

Kjo marrëveshje ka për qëllim, realizimin e veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore në lidhje me çështje të punës dhe jo vetëm; rritjen e bashkëpunimeve për iniciativa të përbashkëta; rritjen e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; si dhe ndërhyrjen pozitive të institucioneve shtetërore sa herë që është e nevojshme.

Neni 3

FUSHA E ZBATIMIT

1. Marrëveshja do të zbatohet midis Palëve të lartëpërmendura në fushën që përmban kjo Marrëveshje për të përmbushur qëllimin e saj.
2. Nëpërmjet kësaj Marrëveshje, Palët angazhohen të:
 - a. Të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit që lidhet me të drejtat dhe mënyrat e mbrojtjes nga diskriminimi në vendin e punës;
 - b. Të përfshihen nëpërmjet angazhimit institucional të përbashkët për ndryshime ligjore që lidhen me fushat me interes të përbashkët;
 - c. Të njoftojnë njeri-tjetrin mbi raste konkrete që kërkojnë trajtim institucional;
 - d. Të organizojnë aktivitete, evente si dhe e projekte të përbashkëta, apo të ftojnë Palën tjetër për pjesëmarrje në konferenca me interes të përbashkët;
 - e. Të përfshihen në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit, ndërgjegjësimit dhe advokacisë;
 - f. Të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen, ndaj lista e mësipërme nuk është e natyrës shteruese.

Neni 4

KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

1. Palët angazhohen të mblidhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj.
2. Palët do të caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret edhe në rrugë operationale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të.
3. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

NENI 5

KOHËZGJATJA

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore pa afat të përcaktuar, për aq kohë sa do të gjykohet si i nevojshëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi midis palëve.

2. Marrëveshja mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, në mënyrë shkresore, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.
3. Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve, duke bërë përpjekje konkrete për zgjidhjen e situatës.
4. Përveç parashikimit të pikës 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim palën tjetër.
5. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë dhe secila palë mban një kopje origjinale.
6. Kjo Marrëveshje është hapur dhe mund t'i bashkohet çdo organizatë jofitimprurëse, objekti i veprimtarisë të së cilës përputhet me këtë Marrëveshje dhe bie dakord me këto parime.

PËR

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

ROBERT GAJDA

KOMISIONERI



PËR

**QËNDRËN PËR TË DREJTAT NË
PUNË**

EDISON HOXHA

DREJTOR EKZEKUTIV

